

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 252/19
 Broj Prot. 252/19
 Prot. No. 252/19
 Data: 19.04.19
 Datum: 19.04.19
 Date: 19.04.19

Nr. i Faqeve 1
 Bc. Stranica 1
 No. Pages 1

PRISHTINE/A



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nr. i Prot. 4191
 Broj Prot. 4191
 Prot. No. 4191
 Data: 23.04.19
 Datum: 23.04.19
 Date: 23.04.19

Nr. i Faqeve 01
 Bc. Stranica 01
 No. Pages 01

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastruktura i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I. Refuzohet kërkesa nr.2141 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Arbeni Tours" shpk me seli në Ferizaj për marrjen e nisjes ne relacionin: Shtime - Ferizaj dhe anasjelltas me orare te nisjes (08:50 - 09:30).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus "Arbeni Tours"SH.P.K me seli në Ferizaj nuk ka plotsuar kushtet ligjore për

ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjeve neShtime - Ferizaj dhe anasjelltas me orare të nisjes (08:50 - 09:30) pasi që referuar në librat e evidencave zyrtare që posedon Departamenti i Transportit Tokësor operatori në fjalë posedon 5 (pesë) leje për operim në transportin nderkombetare të udhëtarëve me autobus, ndaj në bazë të kapaciteteve që disponon sipas dosjes së lëndës aplikuese nuk mundet të mbulojë nisje të tjera respektivisht nuk posedon kapacitetet teknike të mjaftueshme për marrjen e nisjeve të reja.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

mo

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.